



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 31

Tiranë – E martë, 10 shkurt 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 65, datë 6.2.2026	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të dy anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	2547
Vendim i Këshilli i Ministrave nr. 67, datë 6.2.2026	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të pronës me emërtimin “Godina e ish-të përndjekurve politikë”, e cila pozicionohet mbi pasuritë me nr. 6/461, nr. 6/463, nr. 6/262 dhe nr. 6/263 , në zonën kadastrale 8150, Tiranë.....	2547
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1, datë 27.1.2026	Me objekt: 1. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në përfundimin e gjykimit në Kolegj me vendim përfundimtar. 2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin është vendosur shkarkimi nga detyra e magjistrates Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare të pagës dhe të përfitimeve nga magjistratja Mimoza Margjeka.....	2551

**VENDIM****Nr. 65, datë 6.2.2026****PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË DY ANËTARËVE PËR KËSHILLIN
MBIKËQYRËS TË BANKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të dy anëtarëve për Këshillin Mbiqëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

- Znj. Jonida Prifti;
- Z. Ervin Mete.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 67, datë 6.2.2026****PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TE MINISTRIA E
TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TË PRONËS ME EMËRTIMIN
“GODINA E ISH-TË PËRNDJEKURVE
POLITIKË”, E CILA POZICIONOHET
MBI PASURITË ME NR. 6/461, NR. 6/463,
NR. 6/262 DHE NR. 6/263 , NË ZONËN
KADASTRALE 8150, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi te Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit të pronës me emërtimin “Godina e ish-të përndjekurve politikë”, e cila pozicionohet mbi pasuritë me nr. 6/461, nr. 6/463, nr. 6/262 dhe nr. 6/263, zona kadastrale 8150, Tiranë, sipas formularit, planimetrive dhe plan-rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’u përdorur për qëllime kulturore.

2. Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe tjetërsimi i saj.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Identifiktor: KOSTANDIN BUDURUSHI, DREJTOR, DRTK TIRANE

Supervizori: BENIDA KRAJA, DREJTOR, DREJTORIA E POLITIKAVE TE TRASHEGEMISE KULTURORE

Approvi: LLAMBRIOLA MISTO, SEKRETAR I PERGJITHSEM

Instancioni Qendror: Ministria Turizmit , Kulturës dhe Sporteve

Bashkia: Tirane

Fusha e përdorimit të pronës: Monument kulture

A		B		C		D			
Nr.	Zona Kadastr. Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Emërtesa e Pronës Vendndodhja / Shirëzja Gjeografike	Komponentet përberës të Pronës	Adresa/Vendndodhja e komponentëve përberës	Përmasat e Pronës ne m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Situatë juridike (shënimet e veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	ZK.8150 TR.P-12	6461	Godina "Ish te perndjekurit politik"	Truall	Rruga "George W. Bush" Tirane	205.2	Monument Kulture	Ministria Turizmit , Kulturës dhe Sporteve	DRTK Tirane
2	ZK.8150 TR.P-12	Pjesë e pasurisë 6463 6262 6263	Godina "Ish te perndjekurit politik"	Njësi	Rruga "George W. Bush" Tirane	519.2	Monument Kulture	Ministria Turizmit , Kulturës dhe Sporteve	Kati i Parë Teknik Shkallë 34.5 m2
3	ZK.8150 TR.P-12	Pjesë e pasurisë 6463 6262 6263	Godina "Ish te perndjekurit politik"	Njësi	Rruga "George W. Bush" Tirane	413.9	Monument Kulture	Ministria Turizmit , Kulturës dhe Sporteve	Kati i Dytë Teknik Verande 190 m2



PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET DATË: 21/01/2026 QËLLIMI: INVENTARIZIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA: BASHKIA: TIRANE DVASHK/ZVASHK: D.V.A.SH.K- TIRANA VERI ZONA KADASTRALE: 8150 NUMRI PASURISE: 6/461 INDEX HARTE: TR-P-12

TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: TRUALL SIP. E TRUALLIT S=205.2m² SIP. E GJURMËS SË NDËRTIMIT S= m² NR.KATEVE ____ NR.PEMËVE ____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Y = 485118.583 X = 4576838.896 Y = 485406.371 X = 4576838.896

SH: 1:500

TRUALLI PER KALIM NE PERGJ. ADMIN., PAS.6/461
S=205.2m²

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			PASURIA NR.1/30,6/111		
2	LINDJE			PASURIA NR.6/364		
3	JUG			PASURIA NR.6/463		
4	PERENDIM			PASURIA NR.6/217		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: "Noor Engineering" sh.p.k

LICENCA: NR. N.7291/2

NIPT: M41919024C

NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK:

SPECIALISTI:

DVASHK:

NENSHKRIMI:

KONFIRMOI:

PERGJEGJESI/DREJTORI:

NENSHKRIMI / VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, D, O

Kode per teknologji e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET:

EMRI: SHTET

NENSHKRIMI

Enida Sherri

13.04.35 +0200'


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRI I BASHKËPUNIMIT KULTURES DHE SPORTIT
TIRANE

Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE


Sip. ndertimi 553.7 m²
 Sip. shkalle 34.5 m²
 Sip. objektit shtetëror 519.2 m²



 Nr. fletorje: A - 1/2 Skala: 1 : 150	Objekti: GODINE SHITETORE 2 KATE	DREJTORIA VENDORE TRIANA VERI DREJTORI: ERGYST SKENDERI	Vendi: (blank)
	Emri i fletorjes: PLANIMETRIA E KATIT TE PARE	Përgjegjësi i autorizimit të ligjshëm dhe procedurës kalimtare: ILVA MAÇOLLI	Emri i autorizimit: (blank)
Data: 21.01.2026	(Stamp: MINISTRI I KULTURËS DHE MONUMENTET, TIRANË)	Emri i autorizimit: Lila	(Stamp: DREJTORIA VENDORE TRIANA VERI)

PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE

Sip. ndertimi 603.9 m²
 Sip. verande 190.0 m²
 Sip. objektit shtetëror 413.9 m²



 Nr. fletorje: A - 2/2 Skala: 1 : 150	Objekti: GODINE SHITETORE 2 KATE	DREJTORIA VENDORE TRIANA VERI DREJTORI: ERGYST SKENDERI	Vendi: (blank)
	Emri i fletorjes: PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE	Përgjegjësi i autorizimit të ligjshëm dhe procedurës kalimtare: ILVA MAÇOLLI	Emri i autorizimit: (blank)
Data: 21.01.2026	(Stamp: MINISTRI I KULTURËS DHE MONUMENTET, TIRANË)	Emri i autorizimit: Lila	(Stamp: DREJTORIA VENDORE TRIANA VERI)

**VENDIM****Nr. 1, datë 27.1.2026****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji i Posaçëm i Apelit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	kryetar;
Rezarta Schuetz	anëtare;
Natasha Mulaj	anëtare;
Albana Shtylla	anëtare;
Mimoza Tasi	anëtare;
Ina Rama	anëtare,

– mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdiu, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 1, datë 3.5.2024, që i përket:

ANKUESE: Mimoza Margjeka, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, përfaqësuar edhe nga avokatja Margarita Kola

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI: 1. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në përfundimin e gjykimit në Kolegj me vendim përfundimtar.

2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me të cilin është vendosur shkarkimi nga detyra e magistrates Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare të pagës dhe të përfitimeve nga magistratja Mimoza Margjeka.

BAZA LIGJORE: Neni 5, pika 3, shkronja “b” dhe neni 62 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 126 dhe 145 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 45 i ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 4, 18, 22 dhe 140 të Kushtetutës; neni F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 5, 6 dhe 14 [si dhe raporti shpjegues i Protokollit nr. 7]

të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; raporti shpjegues i Konventës Evropiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykrimeve penale CETS nr. 70; neni 441 i Kodit të Procedurës Penale dhe vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 3.11.2014.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, pas shqyrtimit të ankimit dhe prapësimeve të paraqitura nga magistratja Mimoza Margjeka, prapësimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Ankuesja Mimoza Margjeka (në vijim “ankuesja” dhe/ose “magjistratja”) ka ushtruar detyrën e gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Në referim të shpjegimeve dhe të akteve në dosje, ankuesja ishte përfshirë në skemën e delegimit të gjyqtarëve, dhe u dërgua pranë Gjykatës së Apelit Korçë, ku ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar ankimin kundër një vendimi dënimi penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Rasti i shqyrtuar lidhet me disa të pandehur të arrestuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”. Në bazë të disa informacioneve, janë ngritur dyshime për tentativë për veprime korruptive për të lehtësuar masën e dënimit të të arrestuarve. Mbi këtë bazë, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (referuar në vijim si “SPAK” dhe/ose “Prokuroria e Posaçme”) ka nisur hetimet dhe ka vënë nën përgjim disa persona, ndër të cilët ishte ankuesja dhe bashkëshorti i saj, z. A. C.. Pas kryerjes së hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka dërguar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (referuar në vijim si “Gjykata e Posaçme” dhe/ose “GjKKO”) për gjykim ankuesen së bashku me bashkëshortin, avokatin e të arrestuarve dhe familjarë të tyre, për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”.



2.1 Gjykata e Posaçme, mbi kërkesën e SPAK-ut, më datë 5.9.2020, ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, për ankuesen dhe bashkëshortin e saj, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal. Me marrjen e kësaj mase, ankuesja është pezulluar nga detyra me vendim të KLGj-së¹. GjKKO-ja e ka dënuar ankuesen me vendimin nr. {***}, datë 15.12.2022.

2.2 Referuar përmbajtjes së vendimit penal, bashkëshorti i ankuses kishte rolin *klasik* të bashkëpunëtorit. Ai ka marrë kontaktin me përfaqësuesin dhe të pandehurit për të siguruar takimin me ankuesen ditën e gjykimit të ankimit, datë 29.7.2020. Qëllimi i marrëveshjes korruptive ka qenë që ankuesja, për shkak të funksionit si anëtare e trupit gjykues, të ndikonte në zbutjen e masës së sigurimit personal për të pandehurin. Të pandehurit e kanë përmbushur marrëveshjen e korrupsionit nëpërmjet dhënies së përfitimit të parregullt të shumës 6.000 euro për ankuesen, duke përfituar edhe zbutjen e masës së sigurimit personal, nga *arrest në burg* në *garanci pasurore*. Paratë janë dhënë pas dhënies së vendimit. Fakti që masa e sigurimit personal në ngarkim të të pandehurit është zëvendësuar kundrejt dhënies së një përfitimi të parregullt, sipas GjKKO-së, rezulton i provuar edhe me anë të bisedave telefonike të përgjuara mes të pandehurve me njëri-tjetrin dhe me familjarët e tyre.

2.3 Vendimi i GjKKO-së nr. {***}/2022 është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar² (në vijim “Gjykata e Posaçme e Apelit”), me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2023. Si rrjedhojë, ankuesja është

dënuar me vendim penal të formës së prerë, me katër vjet e gjashtë muaj burg, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim. Ky dënim u zëvendësua me 3 vjet shërbim prove dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për 5 vjet.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”)³, bazuar në informacionin në mediat audiovizive ka administruar të dhëna nga sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe konkretisht nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”). Në vijim të këtij informacioni, në datën 18.1.2024, ILD-ja nisi procedim disiplinor *kryesisht* ndaj ankuses dhe, kërkoi fillimin e procedimit disiplinor ndaj veprimtarisë së ankuses, në zbatim të nenit 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës.

3.1 Në përfundim të procedimit disiplinor, ILD-ja ka njoftuar KLGj-në⁴ dhe ankuesen për përfundimin e procedimit. Po ashtu, ILD-ja ka kërkuar nga KLGj-ja caktimin e masës disiplinore të “Shkarkimit nga detyra”, sipas nenit 104 dhe 11 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), pasi vlerësoi se janë plotësuar në mënyrë kumulative dy kushtet: a) gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; dhe (b) vendimi të jetë i formës së prerë.

3.2 Fillimisht, KLGj-ja ka vendosur pezullimin nga detyra të ankuses me vendimin nr. 315, datë 14.9.2020. Më pas, me vendimin nr. 180, datë 9.4.2024, KLGj-ja vendosi shkarkimin nga detyra të ankuses, referuar dispozitave të nenit 147, pika 1,

¹ Sipas vendimit nr. {***}, datë 14.9.2020, “Për pezullimin nga detyra të magjistrates Mimoza Margjeka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, caktuar me skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë, të sipërcituar.

² Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 15.12.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar: “Deklarimin fajtorë të të pandehurës M., për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 319/ç – 25 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, dënimin e saj me 4 (katër) vjet dhe 6 muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur pa vuajtur të tij, duke e vënë të pandehurën M.M. në provë për një periudhë kohe prej Faqe| 2552

3 (tre) vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën e Shërbimit të Provës ku ka vendbanimin e saj. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e së drejtës për të pandehurën M.M. për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5-vjeçar. Në zbatim të nenit 261/1, shkronja “b” e K.Pr.Penale, shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, e parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj së pandehurës M.M., me vendimin nr. {***}, datë 5.9.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar [...]”.

³ Referuar edhe parashtrimet të datës 13.9.2024.

⁴ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2024/05/VENDIM-Nr.180-dat%C3%AB-09.04.2024-P%C3%8BR-CAKTIMIN-E-MAS%C3%8BS-DISCIPLINORE-NDAJ-GJYQTARES-ZNJ.%E2%80%A6.pdf>



nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, disa dispozitave të ligjit nr. 96/2016⁵ dhe të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”⁶, dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative.

3.3. Vendimin e mësipërm të KLGj-së, e ka kundërshtuar ankuesja. Në ankimin e depozituar nga avokatja Margarita Kola⁷, në mënyrë të përmbledhur, kërkohet: i. pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të KLGj-së deri në përfundimin e gjykimit në Kolegj me vendim përfundimtar; dhe ii. shfuqizimi si antikushtetues i vendimit në fjalë të KLGj-së.

3.4 Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 1/1 (JD), datë 29.7.2024, vendosi të kalojë për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve ankimin e magjistrates Mimoza Margjeka dhe ftoi subjektet e interesuara që të paraqesin provat dhe parashtrimet e tyre me shkrim lidhur me ankimin. Ndërkohë, nga të dhënat e pasqyruara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në internet,⁸ Kolegji erdhi në dijeni të faktit që kjo gjykatë ka vendosur në datën 11.12.2025 të mos e pranojë rekursin e paraqitur nga ankuesja ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit që la në fuqi vendimin e shkallës së parë që shpalli atë fajtores.

II. PRETENDIMET NË KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT

II/1. Parashtrimet e ankueses

4. Ankuesja parashtron se vendimi i KLGj-së, i dhënë pas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), i ka shkaktuar asaj një dëm të rëndë, që bie ndesh me parashikimet kushtetuese të zbatimit të vendimit të dhënë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Për këto arsye, ekzekutimi i tij duhet të pezullohet nga Kolegji. Sipas saj, paraqitja e ankimit ndaj vendimit të Komisionit nënkupton të drejtën e saj për të marrë 75% të

pagës, deri në shqyrtimin e çështjes në Kolegj, bazuar në nenin F të Aneksit të Kushtetutës. Sipas ankueses, kemi të bëjmë me një trajtim jo të barabartë e diskriminues, si dhe me cenim të parimit të sigurisë juridike. Po ashtu, ajo pretendon se vendimi është marrë në shkelje të rënda procedurale, në mungesë të saj apo përfaqësueses ligjore. Gjithashtu, ankuesja kërkon të pezullohet vendimi i KLGj-së derisa ajo të ketë një vendim nga Gjykata e Lartë për çështjen penale. Në mënyrë të përmbledhur më poshtë pasqyrohen pretendimet e ankueses të grupuara sipas natyrës së tyre.

4.1 *Së pari*, ankuesja pretendon se vendimi i KLGj-së duhet pezulluar dhe nuk është i ekzekutueshëm pasi ajo ishte e shkarkuar më parë në kuadër të procesit të rivlerësimit nga Komisioni. Vendimi i KLGj-së nuk mund të zbatohet derisa Kolegji të shqyrtojë ankimin kundër vendimit të Komisionit. Ekzekutimi i këtij vendimi me efekt të menjëhershëm, cenon të drejtën për të përfutur 75% të pagës gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit sipas pikës 5 të Nenit F të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 62 të ligjit nr. 84/2016, pasi ajo *ex lege* pezullohet nga detyra. Në këtë rast, asaj i janë cenuar të drejtat themelore për shkak të shkarkimit nga detyra dhe heqjen e statusit të gjyqtarit dhe ndërprerjen e pagës dhe të çdo përfitimi;

4.2 Vendimi i KLGj-së vjen në kundërshtim me nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së, në kushtet kur, në raste të tjera është pritur zbatimi i vendimit të Kolegjit ndërsa në rastin e saj ka ndodhur e kundërta, duke e bërë të ndjehet e diskriminuar (referuar vendimit të GjEDNJ-së, *Biao* kundër Danimarkës [2016]);

4.3 Vendimi i KLGj-së duhet shfuqizuar si antikushtetues. Ajo nuk është njohur me aktet e dosjes nga ILD-ja dhe procedura disiplinore ka nisur

⁵ Nenit 146, pika 2, shkronja “b” dhe nenit 157.

⁶ Nenin 86, shkronja “e” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3 e ligjit të ndryshuar.

⁷ Në prokurën e përgjithshme nr. rep., {***}, nr. kol {***}, datë 9.5.2023, dorëzuar nga përfaqësuesja ligjore, nuk është shënuar në mënyrë eksplicite e drejta e saj për përfaqësim në KLG, por është parashikuar: “[...] të më përfaqësojë dhe mbrojë në të gjitha procedurat administrative apo gjyqësore, civile e penale pranë çdo gjykate të çdo niveli të Republikës së Shqipërisë [...] Gjykatë Kushtetuese. [...] të kryejë dhe realizojë çdo veprim të çdo lloji natyre qoftë pranë çdo organi publik dhe privat në nivel qendror dhe vendor, si: Gjykatë [...] ka të drejtë [...] të bëjë ankim administrativ pranë çdo organi të administratës shtetërore dhe private në emër dhe për llogarinë

time. [...] ka të drejtë të më përfaqësojë në prezencë dhe/ose mungesë në gjykimin e procedimit penal nr. {***}/2020 të Prokurorisë së Posaçme [...] si dhe në të gjitha gjykatat e të gjitha niveleve, si dhe avokatja ka të drejtë të më përfaqësojë në rast konflikti të mundshëm civil/administrativ dhe/ose penal për çdo çështje me çfarëdo objekti që është dhe që do të jetë/ në duke u zhvilluar me cilësinë e paditësit, të paditurit, person i tretë, me dhe pa palë kundërshtare [...]”.

⁸ <https://gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/publiku/informacion-i-ceshtjeve-penale-date-11.12.2025>:

“Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuesit A. C., Mimoza Margjeka, K. Zh. dhe S. D., kundër vendimit nr. {***}, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.



pa u zbardhur vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit. Ankuesja pretendon se nuk kishte mundësi të realizonte mbrojtjen për një vendim me të cilin nuk ishte njohur, si dhe për shkak të mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të hetimit nga ILD-ja. Ajo po ashtu pretendon se vendimi objekt ankimi është marrë në mungesë dhe pa dijeninë e saj përfaqësuesja e saj ligjore, nuk është legjitimuar nga KLGj-ja, ndonëse njoftimet u bënë edhe në adresë të avokates. Refuzimi i prokurës së përgjithshme vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, dhe përbën cenim të procesit të rregullt ligjor (referon vendimet e GjEDNj: *Avotins* kundër Letonisë, 2016 dhe *Dilipak dhe Karakaya* kundër Turqisë, 2014).

4.4 Sipas ankueses, ndodhemi përpara një situatë absurde, pasi, për të njëjtin subjekt, kemi dy vendime shkarkimi, nga dy organe të ndryshme shtetërore, mbi të njëjtin fakt. KLGj-ja duhet të kishte mbajtur në konsideratë kufizimin e dispozitës sipas Aneksit të Kushtetutës për rivlerësimin kalimtar, në vendimin e bazuar në nenin 140 të Kushtetutës dhe nenet 104⁹, 126¹⁰ dhe 145 të ligjit nr. 96/2016. Ndërhyrja nga KLGj-ja është antikushtetuese, pasi ka cenuar të drejtat që mbroreshin nga pika 5 e nenit F të Aneksit të Kushtetutës. Nuk mund të merrej një vendim pas vendimit të Komisionit, pasi ishte e shkarkuar nga detyra.

4.5 Vendimi i GjKKO-së, mbi të cilin janë bazuar Komisioni dhe KLGj-ja për vendimarrjet e tyre, nuk ka marrë formë të prerë; ndaj tij është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Rekursi në Gjykatën e Lartë, si mjet i zakonshëm ankimi, e ndërpret ekzekutimin e vendimit të apelit, pasi forma e prerë lidhet me gjënë e gjykuar. Një vendim bëhet gjë e gjykuar për shkak të pandryshueshmërisë së tij dhe forcës detyruese për të zbatuar¹¹. Kjo situatë ka cenuar sigurinë juridike. Në mbështetje të këtij argumenti, ankuesja referon vendimet e GjEDNj-së në çështjet: *Lekic* kundër Sllovenisë, *Beyer* kundër Italisë, *Hentrich* kundër Francës, *Lethow*

dhe të tjerë kundër Britanisë së Madhe. Ajo pretendon se sipas nenit 126 të ligjit nr. 96/2016, hetimi në ILD duhet të ishte pezulluar deri në dhënie të një vendimi të formës së prerë. Nenet 145 dhe 126, sipas ankueses, parashikojnë se KLGj-ja vendos pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundimin e gjykimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, në mënyrë që vendimi të jetë final dhe të fitojë fuqinë *res judicata*.

4.6 Në datën 22.12.2025, ankuesja ka paraqitur në Kolegj kërkesën për përshpejtim të gjykimit të procesit disiplinor, me pretendimin se i është rënduar pozita procedurale, për shkak se nuk po merr pagat në vijim të ankimit të vendimit të Komisionit (në procesin e rivlerësimit kalimtar).

II/2. Parashtrimet e KLGj-së, datë 16.9.2024

5. KLGj-ja argumenton se pretendimet e ankueses nuk gjejnë mbështetje në prova e në ligj. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor është marrë në zbatim të ligjit. Në mënyrë të përmbledhur, ky qëndrim bazohet në sa vijon.

5.1 Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016, janë dy procese të pavarura nga njëri-tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta. Këto rrethana, pavarësisht se zhvillohen ndaj të njëjtit magistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm.

5.2 Kërkesja ka kërkuar në mënyrë të shprehur në Komision pezullimin e gjykimit dhe vijimin e procedimit disiplinor nga KLGj-ja, si organi kompetent për dhënien e masës disiplinore në rast të një dënimi me vendim të formës së prerë.

5.3 Gjatë procedimit disiplinor, rezultoi e provuar se ankuesja është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi – për veprën penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e kryer në bashkëpunim. Si rrjedhojë, ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e *shkarkimit nga detyra*, e parashikuar në

⁹ Neni 104, *Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një veprë penale*: “[...] 3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë, është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast, gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme”.

¹⁰ Neni 126, *Pezullimi i betimeve*: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e betimit disiplinor kur është duke u zhvilluar betim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. 2. Hetimi pezullohet Faqe | 2554

deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent. [...] Vendimi i formës së prerë i gjykatës në favor të magistratit nuk pengon hetimin nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të magistratit. 5. Pezullimi i betimeve ndërpret afatet e parashkrimit të parashikuara nga neni 117 i këtij ligji, për Inspektoren e Lartë të Drejtësisë. 6. Vendimi për pezullimin e betimit nuk ankimohet”.

¹¹ Ankuesja referon në vendimin unifikues nr. 3/2013 dhe nr. 2/2014, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 29/2006; 24/2008 dhe nr. 2/2013.



nenin 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, si dhe në nenin 111 të ligjit nr. 96/2016.

5.4 Vendimi i Gjykatës së Apelit të Posaçëm nëpërmjet të cilit është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë që ka deklaruar atë faktore, në kuptim të përcaktimeve procedurale penale ka marrë formë të prerë (referuar nenit 462, pika 3, shkronja “b” dhe nenit 428, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale). Gjithashtu, në zbatim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2014, me vendim të formës së prerë do të kuptohet, sipas rastit, vendimi i Gjykatës së Apelit që ka marrë formë të prerë dhe është i ekzekutueshëm. Për këto arsye, nuk gjendemi në kushtet e pezullimit të procedimit disiplinor.

5.5 Pretendimet e kërkuases për një trajtim të pabarabartë e diskriminues, si dhe për cenim të parimit të sigurisë juridike, janë të pabazuar në nenin 157 të ligjit nr. 96/2016. Ndërprerja e përfitimit të pagës dhe përfitimeve të tjera financiare, buron nga ligji. Një vendimarrje e kundërt do të binte ndesh me parashikimet ligjore. Masa disiplinore qëndron në fuqi derisa të vendoset mbi ankimin e paraqitur në gjykatë; nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë. Gjithashtu, ankuesja nuk ndodhet përpara rastit të pezullimit të pagës apo përfitimeve të tjera pasi ajo është e shkarkuar nga detyra për shkak të dënimit me vendim penal të formës së prerë. Si rrjedhojë, trajtimi financiar në përfitimin e plotë të pagës dhe të përfitimeve të tjera, është ndërprerë me vendimin për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

5.6 KLGj-ja ka marrë të gjitha masat për garantimin e procesit të rregullt ligjor. Në çdo fazë të këtij procesi, ka bërë të gjitha përpjekjet për të kryer në mënyrë të saktë njoftimet (elektronike dhe postare), si dhe për të konfirmuar marrjen e tyre nga subjekti i procedimit dhe përfaqësuesja e saj. Gjithashtu, mbi bazë të kërkesës, ankueses dhe përfaqësueses së saj ligjore i është vendosur në dispozicion kopje e dosjes hetimore. Marrja e dosjes dhe dhënia e mundësisë për t'u njohur me të gjithë dokumentacionin dhe për të parashtruar mbrojtje efektive është konfirmuar prej tyre.

5.7 Ankueses i janë komunikuar të gjitha aktet dhe njoftimet, dhe vendosur në dispozicion kopje e dosjes hetimore (pavarësisht vështirësisë së hasur në adresat e saj). KLGj-ja ka shtyrë disa seanca dëgjimore¹² për të siguruar mundësinë e një mbrojtjeje efektive. Nga ana tjetër, nga veprimet dhe mosveprimet e saj, rezulton vullneti i kërkuases për shtyrje dhe zvarritje të *paarsyeshme* të procesit disiplinor. Në kushtet kur nuk kishte asnjë shkak të përligjur për mungesën e znj. Margjeka apo përfaqësueses së saj, KLGj-ja ka vijuar me zhvillimin e seancës dëgjimore.

5.8 Nuk jemi në kushtet e një trajtimi të diferencuar në kushte të njëjta apo të ngjashme me subjekte të tjera (magjistratë). Në zbatim të gjithë kuadrit ligjor, KLGj-ja ka detyrimin të vijojë me procedimin disiplinor e të japë masën përkatëse disiplinore.

5.9 Kërkuësja ka pranuar në procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision se vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë, duke parashtruar shprehimisht se: “Sipas këtij raporti, jemi në kushtet e një dënimi me vendim të formës së prerë, pasi vendimi i fajësisë i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit”. Në këtë rast, ky pretendim i kërkuases është kontradiktor pasi përpara Komisionit ka mbajtur një tjetër qëndrim, duke e vlerësuar vendimin e gjykatës së apelit një vendim të formës së prerë.

5.10 Në konkluzion, KLGj-ja kërkon *rrëzimin e kërkesës*. Pretendimi i kërkuases për pavlefshmërinë e vendimit objekt ankimi bazuar në interpretimin që vendimi penal i Gjykatës së Posaçme të Apelit nuk ka marrë formë të prerë, është i pambështetur në ligj.

II/3. Parashtrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, datë 13.9.2024

6. ILD-ja po ashtu potencon se kërkesa e ankueses duhet rrëzuar dhe ankimi të mos pranohet sipas arsyetimit që vijon.

6.1 Ankueses i është njoftuar vendimi [nr. {***} prot.], datë 20.12.2023, i ILD-së nëpërmjet të cilit është disponuar me *fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë* ndaj saj, sipas dispozitave ligjore që gjejnë

¹² Seancat e datave: 15.2.2024; 29.2.2024; 13.3.2024.



zbatim¹³ dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet që: i. të përfaqësohet vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; ii. ka akses në dosjen e hetimit duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit; iii. të dorëzojë parashitësë dhe dokumente mbështetëse brenda tri javëve nga marrja njoftimit për vendimin e fillimit të hetimit disiplinor; iv. të kërkojë dakordësi mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet; (v) ka të drejtën të njoftohet për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor; vi. të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve të njoftuara, për të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

6.2 Kërkesja është njohur me të drejtat e saj, sikurse konfirmohet nga nënshkrimi i saj me aktin e marrë nëpërmjet njoftimit postar, datë 23.12.2023. Sa më sipër, ILD-ja ka përmbushur me korrektësi detyrimet ligjore të parashikuara nga neni 129 i ligjit nr. 96/2016. Mosushtrimi i këtyre të drejtave nga ankuesja nuk cenon procesin e rregullt. Mosparaqitja e konfirmimit për marrjen dijeni, është pasojë e refuzimit të ankueses për të përmbushur këtë hap procedural dhe këto pretendime nuk mund ta bëjnë në asnjë moment të cenueshme procedurën e ndjekur nga ILD-ja gjatë hetimit disiplinor.

6.3 Ankuesja është dënuar për kryerjen e një krimi, duke u plotësuar kushti i parë për dhënien e masës disiplinore të llojit *shkarkim nga detyra*. Vendimi gjyqësor i dënimit, është i formës së prerë, në kuptim të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale. Me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017, vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë. Janë vendime të formës së prerë, vendimet e gjykatës së apelit kur zgjidhin përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 428 të këtij Kodi.

6.4 Pretendimi i ankueses për të pezulluar vendimin e KLGj-së nuk qëndron. Edhe ajo vetë, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, ka kërkuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit pezullimin e procedurës së rivlerësimit duke cituar edhe nenin 140, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, shprehimisht dhe kërkuar: [...] *vazhdimin e pezullimit të procedurës së vlerësimit e, në rast shkarkimi nga KLGj-ja, do*

të bëni ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj meje. Sipas nenit 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës, kompetente në këtë rast është KLGj-ja.

6.5 Hetimi disiplinor kryesisht është në përputhje me kompetencat kushtetuese. Shkelja disiplinore për të cilën ka filluar lidhet me kryerjen e një krimi për të cilin ankuesja është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Procedura disiplinore nuk analizon ekzistencën e faktit penal apo fajësinë e magistrates. Ekzistenca e një dënimi penal me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, përbën një fakt, me vërtetimin e të cilit ILD-ja është e detyruar të iniciojë procedurën disiplinore dhe të paraqesë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, duke propozuar vetëm masën e shkarkimit nga detyra; këshilli përkatës e finalizon atë procedurë nëpërmjet dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

6.6 Ankuesja kishte mundësinë që të parashtronte qëndrimin e saj gjatë procedurës së hetimit disiplinor, të cilën nuk e ka ushtruar. Për pasojë, nuk mund të pretendohet cenim i procesit të rregullt ligjor nga organi përgjegjës për realizimin e procedurës hetimore. Gjithashtu, ankuesja nuk ka paraqitur parashitësë me shkrim pavarësisht përpjekjeve gjatë procedimit disiplinor dhe mundësive procedurale të ofruara gjatë kësaj faze për t’i garantuar asaj të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u shprehur.

6.7 Afati brenda të cilit ILD-ja duhet të kryejë procedurën e hetimit disiplinor është parashikuar në pikën 2¹⁴ të nenit 118 të ligjit nr. 96/2016. Ai fillon në ditën kur vendoset fillimi i hetimit disiplinor dhe përfundon në ditën kur ILD-ja i paraqet këshillit kompetent raportin e hetimit, sipas nenit 134 të ligjit nr. 96/2016. Brenda afatit gjashtë mujor ILD-ja ka kompetencë për të vlerësuar dhe vendosur kohëzgjatjen e hetimit disiplinor, përcaktuar në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor, dhe mund të zgjatet në rastet e parashikuara nga dispozita ligjore. Nëpërmjet përdorimit të termi “brenda 6 muajve”, legjislatori ka shprehur diskrecionin e ILD-së për të vlerësuar në mënyrë të pavarur kohëzgjatjen e një hetimi disiplinor, në varësi të situatës. Nga ana tjetër, kur një magistrat/e është dënuar me dënim të formës së prerë për kryerjen e

¹³ Neni 123, pika 3, shkronja “dh”, neni 124 dhe neni 129 të ligjit nr. 96/2016, si dhe neneve 35, 42, 45, 78 të Kodit të Procedurave Administrative.

¹⁴ “2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit.”



një krimi, legjislatori ka parashikuar në nenin 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, që gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e ligjit nr. 96/2016 zbatohen për aq sa është e nevojshme. Në këtë rast, ILD-ja dhe KLGj-ja, gjatë procedurës disiplinore, kanë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore që garantojnë të drejtën e ankueses për t'u shprehur dhe për t'u dëgjuar, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Mosezaurimi i qëllimshëm i këtyre të drejtave nga kërkuesja, nuk mund shërbejë si argument për të mbështetur pretendimin për mosrespektimin e tyre nga organet e procedurës disiplinore. Për rrjedhojë pretendimet e ankueses për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, janë tërësisht të pambështetura dhe abuzive.

6.8 Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është në përputhje me parashikimet e nenit 140, pika 2, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, duke qenë se: i. hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe procedimi disiplinor i kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është realizuar në përputhje të plotë me parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor; ii. procedura hetimore ka respektuar në tërësi parimet që udhëheqin këtë proces, të sanksionuara nga neni 100 i ligjit nr. 96/2016; iii. faktin që ankuesja është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

A. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

7. Çështja objekt shqyrtimi i përket juridiksionit disiplinor të Kolegjit, nën dritën e pikës 7 të nenit 179 të Kushtetutës¹⁵. Për rrjedhojë shqyrtimi i saj kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 8577/2000").

7.1 Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, me vendimin nr. 1/1 (JD), datë 29.7.2024, konkludoi se ankimi i plotëson kërkesat për t'i kaluar për shqyrtim në

seancë plenare mbi bazën e dokumenteve, mbledhjes së gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi plotëson kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000.

7.2 Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se ankuesja legjitimohet *ratione personae sipas pikave 2/b e 2/c të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj. Për pasojë, ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

7.3 Ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi është protokolluar në Kolegji në datën 26.4.2024, 15 ditë pas vendimit të KLGj-së, ndërsa afati është 4 muaj¹⁶.

7.4 Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe themeli i tyre do të shqyrtohet në vijim.

7.5 Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelit. Me fjalë të tjera, ankuesja nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit. Kërkimet në ankimin objekt shqyrtimi, nuk rezultojnë të kenë qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese. Përpos sa arsyetuar më sipër, në kushtet që nuk rezulton që ky kërkim të jetë ngritur e trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, as ky kriter përjashtues për shqyrtimin, nuk vërtetohet. Për rrjedhojë, ankuesja po shteron në Kolegji mjetin juridik të ankimit.

B. Vlerësimi i pretendimeve në ankim

8. Nga aktet në fashikull, rezultojnë rrethanat që vijojnë.

i. Më datë 21.12.2023, ILD-ja ka nisur procedim disiplinor *kryesisht*, në ngarkim të ankueses, në vijim të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për

¹⁵ "7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë."

¹⁶ Sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000. Nga aktet, konstatohet se ankimi është regjistruar pas plotësimit të të metave, në datën 3.5.2024, gjithsesi brenda afatit ligjor 4-mujor të përvaktuar nga ligji.



shpalljen fajtores dhe dënimin e ankueses. Referuar nenit 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, ILD-ja ka arsyetuar që dënimi penal është i formës së prerë dhe vepra penale përbën veprime që denigrojnë rëndë figurën e gjyqtarit marrë nga, dhe.

ii. Në datën 18.1.2024, ILD-ja ka dërguar fashikullin në KLGj dhe ka kërkuar marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për ankuesen¹⁷.

iii. Në datën 9.4.2024, pas dy muajsh proces disiplinor, KLGj-ja mori vendimin objekt ankimi me nr. 180, duke vendosur shkarkimin e ankueses nga detyra.

iv. Në Kolegj, ankimi kundër këtij vendimi është depozituar në datën 26.4.2024 dhe është regjistruar në datën 3.5.2024. Kolegji Paraprak, me vendimin (JD) nr. 1/1, datë 29.7.2024, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve.

v. Në datën 11.12.2025, Gjykata e Lartë ka shpallur në faqen zyrtare dispozitivin e vendimit të marrë për mospranimin e rekursit të depozituar nga ankuesja kundër vendimit të gjykatës së Posaçme të Apelit.

8.1 Në ankimin e depozituar në Kolegj kundër vendimit të sipërcituar të KLGj-së, përfaqësuesja ligjore e ankueses, avokatja Margarita Kola, kërkoj: *pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të KLGj-së, deri në përfundimin e gjykimit në Kolegj me vendim përfundimtar; pagesën kalimtare dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 180, datë 9.4.2024, të KLGj-së.*

8.2 Në analizë të sa më sipër, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, Kolegji vendosi të mos pranojë ankimin e kërkeses, duke e gjetur atë të pabazuar në ligj dhe akte. Ky vlerësim mban në konsideratë që procedimi disiplinor i kryer për ankuesen rezulton të ketë qenë në respektim të plotë të të drejtave për proces të rregullt nga njëra anë, dhe të faktit që, nga ana tjetër, në ngarkim të saj, ka një dënim penal për një krim të kryer me dashje. Dy institucionet e referuara më sipër [ILD-ja dhe KLGj-ja] rezulton të kenë vepruar në përputhje me tagrat e tyre kushtetuese e ligjore, duke çelur hetimin disiplinor dhe ndërmarrë veprimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet që

rregullojnë rrethanat ligjore konkrete. Për këto arsye, edhe pretendimet e kërkeses për diskriminim, u gjetën të pabazuara, në kushtet që procedura disiplinore dhe ajo e rivlerësimit janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe ILD-ja e KLGj-ja rezultojnë të kenë qenë në përmbushje të tagrave të tyre kushtetuese. Së fundmi, fakti që vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë nënkupton që, më së paku, duke nisur nga data 11.12.2025, një pjesë thelbësore e argumenteve mbi të cilat bazohet ankimi, ka marrë një përgjigje përfundimtare nëpërmjet lënies në fuqi të vendimit dhe dënimit penal për një krim, në ngarkim të ankueses, që passjell edhe një përgjigje përfundimtare për masën disiplinore të shkarkimit nga KLGj-ja. Arsyetimi i Kolegjit shtjellohet në vijim.

B.I. *Shkaqet e ankimit lidhur me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të KLGj-së dhe dy vendimet e dhëna nga dy organe të ndryshme në të njëjtën kohë*

9. Kërkesja pretendon se, në kushtet që ka pasur një vendim për shkarkimin e saj nga Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit, vendimi i KLGj-së që daton më pas, do të duhet të pezullohet e ajo të vijojë të trajtohet si subjekt i zakonshëm rivlerësimi kalimtar e të përfitojë 75% të pagës¹⁸.

9.1 Kolegji vlerëson se kjo kërkesë është e pabazuar pasi nuk mban në konsideratë autonominë mes procesit disiplinor nga ai i rivlerësimit kalimtar. Ky i fundit përbën një masë të jashtëzakonshme të natyrës kalimtare/të kufizuar në kohë që përfshin kontrollin e gjyqtarëve, prokurorëve në detyrë, e atyre që kanë vullnet të kthehen në sistem, përcaktuar në detaj në pikat 3 dhe 4 të nenit 179/b të Kushtetutës¹⁹. Nga ana tjetër, procesi disiplinor i zakonshëm, i kryer nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, rregullohet nga Kushtetuta dhe ligji nr. 96/2016 dhe kryhet nga ILD-ja e, në këtë rast, KLGj-ja.

9.2 Në rrethanat konkrete, rezulton që, në përputhje me detyrimin e drejtpërdrejtë që rrjedh

¹⁷ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2024/05/VENDIM-Nr.180-dat%C3%AB-09.04.2024-P%C3%8BR-CAKTIMIN-E-MAS%C3%8BS-DISCIPLINORE-NDAJ-GJYQTARES-ZNJ.%E2%80%A6.pdf>

¹⁸ Sipas nenit F të Aneksit të Kushtetutës: “[5.] Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit, subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës [...]”.

¹⁹ Shih, ndër të tjerë, vendimin e GjEDNj-së në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë.



nga nenet 140²⁰ dhe 147/d, pika 1 e Kushtetutës²¹, ILD-ja ka nisur procedimin disiplinor, pasi ka ardhur në dijeni të vendimit penal në ngarkim të kërkuës, të lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit, në dhjetor 2023²². Në kushtet që ankuesja u deklarua fajtores për veprën penale të korrupsionit pasiv, në bashkëpunim, vlerësohet e panevojshme të argumentohet përse ky fakt diskrediton rëndë figurën e gjyqtarit. Dispozitat e mësipërme nuk u lënë diskrecion apo kompetencë organeve të qeverisjes për vlerësimin e *shkeljes* apo të *fajësisë* së magjistratit. Me përfundimin e procedimit disiplinor, ILD-ja i ka dërguar KLGj-së kërkesën për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për ankuesen. Detyrat e KLGj-së, në funksion të sigurimit, ndër të tjera, edhe të përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor²³, përfshijnë edhe marrjen e vendimeve me natyrë disiplinore.

9.3 Kolegji arrin në konkluzionin që dinamika e procesit disiplinor të ndjekur nga ILD-ja e përfunduar nga KLGj-ja, daton pas vendimit për rivlerësimin vetëm si pasojë e disa vonesave që janë shkaktuar nga vetë ankuesja. Në këtë linjë, argumentet e ngritura në ankim, kanë për synim krijimin e kushteve për një situatë favorizuese për ankuesen nëpërmjet potencimit të këndvështrimeve e interpretimeve ligjore të fragmentarizuara, dhe jo një nevojë të mirëfilltë për të korrigjuar një “dëm” apo shëruar një të drejtë kushtetuese të cenuar. Sikurse shtjellohet në detaj në analizën për pretendimet për cenim të procesit të rregullt, KLGj-ja ka shtyrë tri herë seancat²⁴ e caktuara gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të ankueses. Dy

prej tyre janë shtyrë me kërkesë të shprehur të ankueses, njëra me kërkesë të avokates për të mundësuar përditësimin e prokurës së përfaqësimit.

9.4 Përpos shtyrjeve, KLGj-ja ka hasur vështirësi për dorëzimin e akteve fizikisht *tri herë* dhe në gjithë adresat e referuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e KLGj-së²⁵. Për herë të parë, ankuesja ka shpjeguar largimin nga Tirana në kërkesën dërguar KLGj-së në datën 21.2.2024, pasi kishte dështuar edhe përpjekja e tretë e KLGj-së për dërgimin e akteve në tri adresa të ndryshme në qytetin e Tiranës. Si pasojë e këtyre shtyrjeve, seanca e KLGj-së, fillimisht e caktuar në datën 15.2.2024, u zhvillua vetëm në datën 9.4.2024, ndërsa procesi i komunikimit për të mundësuar njohjen e akteve dhe seancën kishte nisur më së paku që më 31.1.2024, edhe duke abstraguuar nga njofimi i kryer nga ILD-ja kërkuës që në datën 20.12.2023.

9.5 Ankuesja ka qenë plotësisht e qartë për dinamikën e pasojat e ngjarjeve dhe detyrimet e secilit institucion, përfshirë edhe ato të organeve të qeverisjes së sistemit gjyqësor, në kushtet që gjatë procesit të *rivlerësimit kalimtar [vetting]*, në prapësim të një Opinioni të Vëzhguesit Ndërkombëtar të ONM-së, ajo i ka kërkuar Komisionit *peçullimin* e procedurës [së rivlerësimit]. Konkretisht, ankuesja ka kërkuar shprehimisht në datën 5.2.2024: [...] *vazhdimin e peçullimit të procedurës së vlerësimit e, në rast shkarkimi nga KLGj-ja, [...] ndërprejten e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj meje. Sipas nenit 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kompetente në këtë rast është KLGj-ja [...]*²⁶.

²⁰ “[2.] Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi [...]”.

²¹ “[1.] Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj [...]”.

²² Me vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit, në datën 12.12.2023, sikurse referuar më sipër, ankuesja u dënua me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.

²³ Neni 147 i Kushtetutës përcakton që: “[1.] Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pararesinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë [...]”.

²⁴ Konkretisht, janë shtyrë seancat e datave 15.2.2024, 29.2.2024 dhe 13.3.2024.

²⁵ Referuar paragrafëve 21, 22 dhe 23 të vendimit objekt ankimi.

²⁶ Kërkuësja ka parashtuar: “Në lidhje me këtë pretendim të bërë nga ONM-ja, ju citoj nenin 140, pika 2/b e Kushtetutës, në të cilin është parashikuar se gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. [...] në këtë rast, organi administrativ që vendos është Këshilli i Lartë Gjyqësor. [...] ju informoj se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor është caktuar data e seancës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për përfundimin e hetimit disiplinor [...] dhe, me vendimin e datës 18.1.2024 të ILD-së, është vendosur propozimi i masës disiplinore shkarkim nga detyra, parashikuar nga neni 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në datën 19.1.2024, jam vënë në dijeni të akteve të nxjerra nga ILD [...]. Në përfundim të hetimit disiplinor nga ILD-ja, është propozuar marrja e masës disiplinore ndaj magistrates Mimoza Margjeka, shkarkim nga detyra, bazuar në nenin 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 104, pika 3 dhe neni 111, pika 1/b e ligjit nr. 96/2016. Në raportin e ILD-së, datë 18.1.2024, [...] thuhet se jemi në kushtet e një dënimi me vendim të formës së prerë, pasi vendimi i fajësisë i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është lënë në fuqi



9.6 Me vendimin nr. 739, datë 26.2.2024, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra ankuesen, në procesin e rivlerësimit kalimtar, me arsyetimin se dënimi i saj me vendim të formës së prerë ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Procedura e kryer nga Komisioni, ka qenë tërësisht e pavarur nga ajo e zhvilluar në KLGj-ja dhe rregullohet në mënyrë të mëvetësishme nga parashikimet kushtetuese dhe ligjore. Sikurse rezulton edhe nga burimet e hapura, të sipërcituara, edhe subjekti ka qenë në të njëjtën linjë argumenti gjatë procesit të rivlerësimit, në kushtet që ka kërkuar vazhdimin e pezullimit në pritje të një vendimmarrjeje nga organet e përhershme të qeverisjes, sikur është në këtë rast KLGj-ja.

9.7 Përpos sa më sipër, ankuesja nuk rezulton të ketë argumentuar në kërkesën për pezullim as pasoja shtetërore, shoqërore apo individuale të pariparueshme që ka passjellë vendimi i KLGj-së për të, nën dritën e nenit 45²⁷ të ligjit nr. 8577/2000, apo për të arsyetuar përse, në rast se Gjykata e Lartë vendos ndryshe/kundër nga gjykatat e faktit, pasojat nuk mund të riparohen. Sikurse është arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 54/2024, pezullimi përbën një masë të jashtëzakonshme që vendoset në rast të pasojave të pariparueshme ose efekteve të zbatimit të aktit, të cilat duhet të jenë reale dhe të rënda, në atë masë që të shkojnë tej masës normale të kufizimit, në veçanti në pikëpamje të urgjencës. Për më tepër, në nenin 157 të ligjit nr. 96/2016, është parashikuar e drejta e magjistratit për të përfituar pagat e mbajtura nga Këshilli në rast të një vendimi në favor të saj/tij²⁸. Pavarësisht se në rastin konkret, nuk gjendemi përpara mbajtjes së pagës si masë disiplinore, kjo dispozitë konfirmon më tej faktin që nuk ka vend pretendimi se asaj i janë cenuar të drejtat kushtetuese apo që vendimi i shkarkimit të saj është kryer në rrethana që legjitimojnë pezullimin e zbatimit. Për pasojë, në

kushtet kur ankuesja nuk paraqiti asnjë argument për pezullimin, përpos interesit individual në formën e pagave, për të cilat ka një rregullim ligjor për kthimin në rast të një vendimi në favor të ankuses, kërkesa për pezullim u vlerësua e pabazuar.

9.8 Për sa më lart, nuk qëndron pretendimi për cenim të të drejtave kushtetuese meqenëse ankuesja fitoi cilësinë e subjektit të rivlerësimit në statusin në ankim – dhe, për pasojë, formalisht edhe statusin në të cilin përfitonte 75% të pagës – përpara shkarkimit nga KLGj-ja e humbjes së statusit të magjistrates. Ky konkluzion mbështetet në argumentet si vijojnë.

9.9 Së pari, masa disiplinore e marrë nga KLGj-ja bazohet në një kuadër tjetër ligjor, të ndryshëm nga ai mbi të cilin funksionojnë organet e rivlerësimit. Së dyti, shkarkimi nga detyra për ankuesen, për kryerjen e veprave penale që lidhen me veprime që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit²⁹, në zbatim të nenit 140 të Kushtetutës, passjell edhe humbjen e statusit të magjistratit dhe përfitimet e pagës. Në këtë kuptim, në zbatim të vendimit të shkarkimit, ankuesja ka humbur edhe statusin e magjistrates dhe paga nuk mund të mos ndërpritej. Për rrjedhojë, vendimi i KLGj-së, i dhënë me efekt të menjëhershëm, nuk përbën cenim të së drejtës së pagës, pasi është një zbatim i drejtpërdrejtë i ligjit, sipas nenit 157, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

9.10 Së fundmi, por jo nga rëndësia, Gjykata e Lartë, në datën 11.12.2025, vendosi të mos e pranojë rekursin kundër dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që e deklaruan ankuesen fajtores. Pretendimi i ankuses se vendimi i KLGj-së duhej pezulluar, në pritje të vendimmarrjes për rekursin e ushtruar prej saj, tashmë është pa objekt. KLGj-ja ka marrë masën disiplinore referuar ekzekutueshmërisë së vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit nën dritën e nenit 462³⁰ të Kodit të Procedurës Penale, duke mos pasur asnjë opsion të ndryshëm, në përputhje me nenin 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës. Sikurse ka

nga Gjykata e Posaçme e Apelit. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj vazhdimin e pezullimit të procedurës së vlerësimit e, në rast shkarkimi nga KLGj-ja, do të bëni ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj meje. [...] Ankimi ndaj vendimit të KLGj-së do të shqyrtohet nga Kolegji i Apelit [...]”. Referuar: <http://magjistrat.al/dokumenta/1713515295Vendim-M-Margjeka-dt-20.3.2024.pdf>, faqet 9 dhe 10 të vendimit.

²⁷ “[1:] “Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin

e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi [...]”.

²⁸ “[4.] Nëse vendimi i dhënë nga gjykata më e lartë është në disfavor të magjistratit, shumat e mbajtura, sipas pikës 2 të këtij neni, vazhdojnë të mbahen derisa çështja penale ose disiplinore, për të cilën është vendosur pezullimi i përfitimit, të përfundojë me vendim të formës së prerë”.

²⁹ Paragrafi 77 i vendimit objekt shqyrtimi, nr. 180/2024.

³⁰ Neni 462 i Kodit të Procedurës Penale përcakton që: “[...] janë vendime të formës së prerë [...] vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1 të nenit 428 të këtij Kodi”.



shtjelluar Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 29/2001:

[...] Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se, për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar.

9.11 Pika 3 e nenit 104 të ligjit nr. 96/2016, përcakton shprehimisht se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi, siç është rasti konkret. Në vijim të sa më lart, pretendimi i ankueses për të pezulluar zbatimin e vendimit të KLGj-së dhe efekteve të menjëhershme që lidhen me pagën, derisa të shqyrtohet nga Kolegji ankimi kundër vendimit të Komisionit, nuk qëndron pasi përbën një interpretim të zgjeruar të mënyrës sesi mund të procedojnë organet e kontrollit të përhershëm në harkun kohor gjatë të cilit funksion edhe procesi i rivlerësimit, duke përdorur për këtë shkak edhe vonesat e shkaktuara nga veprimet e asaj vetë. Për sa më lart, pretendimet e ankueses që lidhen me cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak të gjendjes para vendimmarrjes së Komisionit dhe më pas të KLGj-së, nuk qëndrojnë.

B.II. Për pretendimet që lidhen me zbatimin e procesit të rregullt ligjor

10. Ankuesja pretendon se nuk është njohur me aktet e dosjes nga ILD-ja për shkak të mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të hetimit dhe se procedura disiplinore ka nisur pa u zbardhur vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit, me pasojë pamundësinë e realizimit të mbrojtjes nga ajo. Ankuesja duket se fokusohet në faktin që vendimi penal që ka përbërë shkas për procedurën disiplinore, disponohej vetëm në versionin e shkurtër. Nga ana tjetër, palët e interesuara – ILD-ja

dhe KLGj-ja – në parashtrimet e dërguara në Kolegji për efekt të këtij procedimi, fokusohen në faktin që ankuesja është njohur gjatë gjithë procedurës disiplinore me çdo veprim të ndërmarrë dhe ka zgjedhur të mos ushtrojë të drejtat e mbrojtjes.

10.1 Kolegji vëren se ky pretendim i ankueses është i pabazuar, parë nga disa këndvështrime. Procesi i kryer në funksion të masës disiplinore të shkarkimit të ankueses nga detyra, është i bazuar në ligj. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në vijim.

10.2 Së pari, ndërsa arsyetimi i plotë i vendimit penal mund të paraqesë rëndësi në ushtrimin efektiv të të drejtave të ankueses në procesin *penal*, ai nuk mund të afektonte në rastin konkret mbrojtjen e ankueses në procesin disiplinor të kryer nga KLGj-ja dhe ILD-ja. Këto dy organe nuk analizojnë fajësinë apo ekzistencën e faktit penal të elementeve që përbëjnë figurën e veprës penale. Ekzistenca e një dënimi penal përbën një fakt me të cilin ILD-ja dhe KLGj-ja janë të detyruara përkatësisht të iniciojnë procedurën disiplinore dhe marrin masën disiplinore të shkarkimit, duke u kufizuar vetëm me konstatim të faktit.

10.3 Së dyti, pretendimi i ankueses për shkelje të afatit 15-ditor sipas ligjit ³¹, gjendet i bazuar vetëm për seancën e parë. Konkretisht, njoftimi për seancën e datës 15.2.2024, është marrë prej ankueses vetëm 10 ditë përpara, në datën 5.2.2024, ndërsa edhe vetë vendimi për fillimin e procedurës disiplinore dhe caktimin e datës së seancës, është marrë në kufijtë minimalë prej “të paktën 15 ditë”, të përcaktuar nga ligji, në datën 31.1.2024. Pavarësisht nga kjo situatë fillestare, në kushtet që gjatë procesit KLGj-ja është kujdesur të akomodojë ankuesen për t’i dhënë kohën e nevojshme sipas kërkrimeve të saj, procesi disiplinor i kryer, parë në tërësinë e tij, rezulton në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi KLGj-ja ka dhënë kohë shtesë dhe akomoduar gjithë kërkrimet e ankueses. Seancat e tjera janë caktuar duke i dhënë ankueses kohë të mjaftueshme, sikurse rezulton edhe nga fakti që seanca dëgjimore ka ndodhur në fakt në muajin prill.

10.4 Së treti, dhe përpos sa referuar më sipër, nga kontrolli i akteve të përcjella në Kolegji nga subjektet

³¹ Neni 138, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, përcakton që: “[2.] Këshilli: a) përcakton datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda një muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i

Drejtësisë; b) njofton palët për datën e seancës dëgjimore të paktën 15 ditë para saj [...]”.



e interesuara dhe nga vendimi i Komisionit³², evidentohet qartë që ankuesja ka qenë në dijeni të hetimit disiplinor përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tij në ILD e KLGj, duke filluar nga data 26.12.2023 e në vijim³³. Në të njëjtën linjë, edhe në tri kërkesat e drejtuara KLGj-së, datë protokollimi 24.1.2024, datë 9.2.2024 dhe datë protokollimi 21.2.2024, ankuesja konfirmon njohjen me vendimmarrjet e këtij institucioni për seancën dëgjimore dhe për fillimin e procedurës³⁴ disiplinore në ngarkim të saj, potencon që përfaqësimin do ta kryejë avokatja me prokurë dhe konteston kryesisht kohën e shkurtër në caktimin e seancës së parë, sikurse edhe që vendimi penal nuk është i formës së prerë. Këto ndërveprime me ankuesen gjejnë pasqyrim edhe në vendimin objekt ankimi të KLGj-së e janë bërë pjesë e arsytimit të tij³⁵.

10.5 Në funksion të sa më sipër dhe si pikënisje e arsytimit përse këto pretendime të ankueses nuk qëndrojnë, Kolegji çmon të sjellë në pah sa vijon, nga aktet në fashikull, përcjellë nga palët e interesuara.

i. Në vijim të kërkesës së ankueses, më datë 9.2.2024, KLGj-ja ka shtyrë seancën dëgjimore për në datën 29.2.2024. Disa ditë më pas, në datën 13.2.2024, KLGj-ja i ka nisur ankueses dosjen hetimore të ILD-së, pa sukses. Në shkresën përcjellëse, kthyer më datë 16.2.2024, KLGj-ja ka konstatuar se dosja ka mbetur e *padorëzuar* tek ankuesja, me shënimin: “Larguar; adresë tjetër; e ka dhënë shtëpinë me qira”. Nuk rezulton që ankuesja të ketë kontestuar apo pretenduar të ketë njoftuar KLGj-në rreth ndryshimit të adresës së saj, ndonëse është paraqitur personalisht pranë këtij institucioni në datën 15.2.2024.

ii. Në datën 15.2.2024, ankuesja ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore të caktuar atë ditë, me pretendimin se nuk është njohur me dosjen hetimore të ILD-së, dhe ka kërkuar pezullimin e procedimit disiplinor deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Po ashtu, ankuesja kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore edhe nëpërmjet një raportit të paaftësisë në punë. Përfaqësuesja e ILD-

së ka kërkuar vijimin e procedurës disiplinore duke theksuar që ankuesja ka marrë me shërbimin postar të gjitha aktet shkresore, është njohur me procedurën disiplinore, është njohur me vendimin e ILD-së nr. {***}, datë 20.12.2023, që ka nisur procesin dhe nuk e ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes.

iii. Në vijim të sa më sipër, KLGj-ja ka shtyrë seancën për në datën 13.3.2024 dhe i ka nisur ankueses *sërish* raportin e ILD-së, në *tri adresa banimi* të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në KLGj, pa sukses. Shkresa nuk ka arritur në asnjë prej adresave, me zarfin me shënimin: “Larguar”. Gjendur në kushtet e pamundësisë së dërgimit të akteve shkresore në adresat e ankueses, KLGj-ja i ka nisur ato nëpërmjet postës elektronike në datën 21.2.2024.

vi. Në datën 29.2.2024, KLGj-ja ka pranuar kërkesën e përfaqësueses ligjore të ankueses, dërguar një ditë më parë, më 28.2.2024, duke e shtyrë seancën dëgjimore për datën 13.3.2024, dhe duke referuar mundësimin e mbrojtjes efektive për ankuesen. Rezulton se kërkesa për shtyrje nuk ka për bazë mosnjohjen me aktet. Për pranimin e kërkesës dhe shtyrjen e afatit, është njoftuar ankuesja dhe avokatja në adresën e banimit, sikurse edhe nëpërmjet postës elektronike, në datën 29.2.2024. Edhe në këtë rast, shërbimi postar nuk ka arritur dërgimin. Njoftimi është kthyer me shënimin “Adresë e pamjaftueshme”. Nuk rezulton të ketë informacion, e as pretendime nga ankuesja nëpërmjet të cilave të kontestonte saktësinë e adresës apo të shpjegonte arsyet për të cilat adresa e dhënë prej saj ishte e paplotë.

v. Përpara seancës së shtyrë si më sipër, ankuesja ka dërguar në KLGj, një kopje të prokurës së përgjithshme të përfaqësimit [nr. rep. {***}, nr. kol. {***}], datë 9.5.2023³⁶. Në vijim, në datën 22.2.2024, KLGj-ja ka dërguar nëpërmjet postës elektronike, aktet, përfshirë raportin e hetimit të ILD-së në adresë të ankueses dhe në adresë të përfaqësueses me prokurë. Përfaqësuesja ka marrë dijeni rregullisht pasi ka nënshkruar

³² Aksesuar nga burime të hapura: <http://magjistral.al/dokumenta/1713515295Vendim-M-Margjeka-dt-20.3.2024.pdf>.

³³ Referuar kërkesës së ankueses KLGj-së, më 24.1.2024.

³⁴ Shkresat e KLGj-së si vijojnë: njoftim me nr. prot {***}, datë 5.2.2024; vendim nr. {***}, datë 31.1.2024, për caktimin e datës

për zhvillimin e seancës dëgjimore; njoftim nr. prot. {***} dhe {***}, datë 5.2.2024.

³⁵ Referuar vendimit objekt ankimi, paragrafët 12, 13, 14 dhe prapësimeve të ILD-së, kërkesja ka konfirmuar marrjen njoftim të tri shkresave të KLGj-së, përpos komunikimeve elektronike, si dhe konfirmuar marrjen e shkresave të ILD-së më herët.

³⁶ Ankuesja përfaqësohet edhe në Kolegji me të njëjtën prokurë.



lajmërimmarrijen. Në të njëjtën shkresë, i është bërë me dije përfaqësueses se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 29.2.2024.

vi. Në seancën e datës 13.3.2024, është paraqitur avokatja/përfaqësuesja me prokurë. Sikurse kishte udhëzuar që në seancën e datës 29.2.2024, KLGj-ja ka *përsëritur* kërkesën për prokurë përfaqësimi të posaçme në emër të avokates. Përditësimi i prokurës referohet të jetë kërkuar për të garantuar procesin, duke mbajtur parasysh edhe që prokura [e përgjithshme] e depozituar ishte lëshuar rreth *një* vit para procedimit disiplinor. KLGj-ja i dha avokates tri javë kohë për ta përmbushur këtë udhëzim dhe shtyu seancën dëgjimore për në datën 9.4.2024.

vii. Në datën 8.4.2024, një ditë përpara seancës së radhës, avokatja ka njoftuar KLGj-në se ende nuk ishte pajisur me prokurë të posaçme, dhe kërkoj *përsëri* shtyrjen e seancës për të njëjtin qëllim³⁷.

viii. Në seancën e datës 9.4.2024, nuk janë paraqitur as avokatja, as ankuesja. Seanca dëgjimore është zhvilluar në mungesë pasi KLGj-ja ka mbajtur në konsideratë: 1. dënimin penal me vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit; 2. faktin që vetë avokatja dakordësoi për paraqitjen e prokurës së posaçme; 3. mungesën e pengesave ligjore të paraqitjes së prokurës së posaçme; dhe 4. mosparaqitjen e ankueses apo avokates në seancë, ndonëse të njoftuara rregullisht.

10.6 Nga analiza e ngjarjeve të ekstraktuara e përmbledhura më sipër, Kolegji konstaton që ILD-ja dhe KLGj-ja kanë përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji nr. 96/2016 për të zbatuar në praktikë garancitë për një proces të rregullt ligjor. Mes tyre, dy institucionet kanë dërguar një sërë shkresash, qoftë nëpërmjet shërbimit postar apo postës elektronike eventualisht, në adresë të ankueses dhe përfaqësueses së saj ligjore. KLGj-ja rezulton të ketë ndërmarrë një sërë hapash për t'ia dërguar aktet ankueses³⁸. Deri në datën 21.2.2024, ankuesja nuk ka saktësuar apo përditësuar adresën ku do të duhet të dërgoheshin aktet gjatë procedurës disiplinore ose një pjesë të saj.

10.7 Rezulton se, nga momenti kohor kur KLGj-ja ka nisur procesin disiplinor, më 31.1.2024, deri në datën kur është zhvilluar seanca dëgjimore [në mungesë] dhe marrë vendimi objekt ankimi, më

9.4.2024, janë shtyrë *tri* seancat e caktuara, përkatësisht në datat 15 shkurt, 29 shkurt dhe 13 mars 2024, me qëllim që t'i jepej kohë ankueses dhe avokates të përgatiteshin dhe të merrnin pjesë efektivisht në proces, duke u dëgjuar e përcjellë dokumentacion e prapësime në zbatim të garancive për një proces të rregullt. KLGj-ja i ka bërë ankueses me dije të drejtat: i. për t'u mbrojtur vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative; ii. e aksesit në dosjen e hetimit, duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në një masë që është në përputhje me objektin e hetimit; iii. për të dorëzuar parashtrësia dhe dokumente mbështetëse brenda tri javëve nga marrja njoftimit për vendimin e fillimit të hetimit disiplinor; iv. e kërimit të dakordësisë mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet; v. për t'u njoftuar me çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor; vi. për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të njoftuara, për të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

10.8 Nën dritën e nenit 143 të ligjit nr. 96/2016, seanca dëgjimore mund të shtyhet nga këshilli kur e konsideron të nevojshme marrjen e provave shtesë, por jo më shumë se një muaj. Kohëzgjatja e procedurës disiplinore në KLGj, ka përfshirë harkun kohor për mbi dy muaj, për shkaqe që lidhen tërësisht me zgjedhje të ankueses. Për sa më sipër, në kushtet që ankuesja nuk kishte pengesa e kufizime lirie për shkak të dënimit penal, mosushtrimi i të drejtës së mbrojtjes, gjatë mbi dy muajve, apo kërkesat e përsëritura për shtyrje, ndërkohë që komunikimi mes saj e KLGj-së rezulton nga aktet të ishte në disa raste vetëm i njëkahshëm [prej saj në drejtim të KLGj-së], Kolegji vlerëson se pretendimi për cenim të procesit të rregullt, është i pabazuar. Ankuesja nuk u angazhua që të ushtronte mbrojtje për çështjen e saj.

10.9 Nga përmbajtja e ankimit, nuk rezulton që ankuesja të ketë pasur vështirësi për të plotësuar apo përditësuar prokurën e përfaqësimit në emër të avokates së zgjedhur prej saj. Mbi të gjitha, pavarësisht nga kërkesa për përditësim prokure, KLGj-ja nuk ka refuzuar gjithsesi përfaqësimin prej saj dhe ankuesja nuk rezulton të ketë hasur pengesë

³⁷ Referuar kërkesës me shkrim të protokolluar në KLGj me nr. {***} prot., datë 8.4.2024.

³⁸ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2024/05/VENDIM-Nr.180-dat%C3%AB-09.04.2024-P%C3%8BR-CAKTIMIN->

<E-MAS%C3%8BS-DISCIPLINORE-NDAJ-GJYQTARES-ZNJ.%E2%80%A6.pdf>



për të paraqitur parashtrime vetë ose nëpërmjet avokates. Përkundrazi, shtyrja e fundit trejavore, dhënë avokates për përditësimin e prokurës, nuk është kontestuar prej ankueses, as ka cenuar të drejtat e saj në kushtet që përbënte kohë në dispozicion dhe një mundësi të re për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proces. Marrja e vendimit në mungesë të ankueses mbetet e vetmja alternativë në procesin disiplinor të kryer nga KLGj-ja.

10.10 Për rrjedhojë, edhe mosmarrja pjesë në asnjë prej seancave, rezulton të jetë zgjedhje e saj personale. Në kushtet që as ankuesja nuk i konteston njoftimet për sa më sipër, mosnjohja e akteve është pasojë direkte e zgjedhjeve të bëra nga ankuesja. Duke qenë se ankuesja ka konfirmuar qoftë në korrespondencën me KLGj-në, ashtu edhe në procesin e rivlerësimit në Komision, dijeninë e plotë për procesin disiplinor dhe marrjen e akteve, deduktohet se ankuesja ka bërë zgjedhje të mos përcjellë parashtrime e akte, e as të marrë pjesë në procesin e hetimit disiplinor. Ky konkluzion përforcohet edhe duke mbajtur parasysh vështirësitë që i ka krijuar ankuesja KLGj-së për dorëzimin e akteve në adresat e banimit, sikurse konstatohet në fashikujt e KLGj-së (referuar më sipër.) Si rrjedhojë, është i pabazuar pretendimi për cenim të procesit të rregullt edhe nën këtë këndvështrim. Në kushtet që ajo vetë ka zgjedhur të mos ushtrojë të drejtën për t'u mbrojtur e paraqitur akte, ky pretendim i ankueses rezulton i pambështetur në akte e rrethanat faktike, e i pakuptimtë.

B.III. Analiza e pretendimeve për antikushtetutshmëri të vendimit objekt ankimi të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për cenim të parimit të sigurisë juridike

11. Ankuesja pretendon se i është cenuar *siguria juridike* dhe se ajo ka qenë subjekt i një trajtimi të *pabarabartë* dhe *diskriminimi*, parashikuar në nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNj-së. Ky argument bazohet kryesisht në interpretimin e ankueses për natyrën e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit që, sipas saj, nuk është i formës së prerë, si dhe në pretendimin që procesi disiplinor i kryer për rastin e saj, ka ndjekur ritme të shpejta.

11.1 Analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, tregon që edhe ky pretendim është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Kolegji nuk konstatoi rrethana që do të tregonin qasje diskriminuese nga ILD-ja e KLGj-ja. Ankuesja është njoftuar rregullisht dhe janë kryer gjithë përpjekjet gjatë procesit disiplinor për t'i lejuar asaj të ushtronte të drejtat për proces të rregullt. KLGj-ja ka akomoduar edhe kërkesat e ankueses për kohë shtesë, sikurse është arsyetuar më sipër. Nga ana tjetër, marrja e masës disiplinore të shkarkimit, ishte e vetmja alternativë ligjore ndërsa vendimi i Gjykatës së Apelit ishte i ekzekutueshëm. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, shtjellohet në detaj në vijim.

11.2 Së pari, Kolegji vëren se ankuesja nuk parashtron të ketë ndonjë prej cilësive të mbrojtura nga neni 18 i Kushtetutës apo 14 i KEDNj-së³⁹. Për rrjedhojë, nga analiza në nivel teorik e këtij pretendimi, Kolegji nuk konstaton, së pari, që nga aktet të rezultojë qasje diskriminuese apo që ankuesja të jetë shprehur në procesin disiplinor se gëzon ndonjë nga cilësitë e mbrojtura nga këto dispozita kushtetuese e konventore. Në kushtet që procesi disiplinor për të, ka përfshirë edhe shtyrjen e dy seancave dhe vendimmarrja e KLGj-së është marrë për mbi dy muaj pas marrjes së raporteve nga ILD-ja, edhe kohëzgjatja e procesit nuk dëshmon për veprime paragjyquese e diskriminuese.

11.3 Sikurse potencojnë KLGj-ja dhe ILD-ja, Kushtetuta nuk parashikon për këto organe, një mënyrë alternative veprimi. Procesi i hetimit disiplinor dhe vendimmarrja objekt ankimi janë kryer *pasi* ka nisur edhe ekzekutimi i vendimit penal, për shkak të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ndërsa ligji ka parashikuar edhe mënyrën e shërimit dhe rivendosjes së të drejtave, në rast se ankuesja do të kishte marrë një vendim në favor të saj pas rekursit të ushtruar në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, parë edhe në këtë këndvështrim, mënyra sesi është kryer procesi disiplinor për ankuesen, është e bazuar në ligj.

11.4 Kolegji vëren se pjesë e rëndësishme e kërkimeve të ankueses, është koncepti i formës së

³⁹ Neni 18 i Kushtetutës parashikon: "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuba, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjeje e Faqe | 2564

arsyeshme dhe objektive." Ndërsa neni 14 i KEDNj-së parashikon: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuba, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër".



prerë, marrë në analizë e shtjelluar nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 2/2014. Në linjë me këtë kërkim, ndërsa interpretimi i ankueses ishte i drejtë deri në vitin 2017, me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017, sikurse referuar më sipër, në paragrafin 9.9 dhe poshtëshënimin nr. 30, nën dritën e nenit 428, pika 1, germa “b” dhe nenit 462, pikat 1 dhe 3, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit që la në fuqi vendimin e fajësisë në ngarkim të ankueses dhe ekzekutimi i këtij vendimi nga prokurori⁴⁰, është i formës së prerë dhe nuk mund të argumentohet se lë diskrecion për organet e qeverisjes së sistemit gjyqësor për të mos zbatuar një dispozitë që, në mënyrë të shprehur, përcakton çfarë përbën vendim penal i formës së prerë, apo për të mos ndërmarrë hapat e parashikuar në mënyrë të shprehur nga Kushtetuta e ligji për mënyrën sesi veprohet për magjistratët në detyrë, statusi i të cilëve rregullohet e funksionon nëpërmjet këtyre organeve, në rast se ka vendim penal për kryerjen e një krimi. Në rrethanat aktuale, edhe duke abstraguuar nga sa më sipër, Kolegji çmon të theksojë edhe faktin që Gjykata e Lartë tashmë ka marrë një vendim për rekursin e ushtruar nga ankuesja në datën 11.12.2025⁴¹. Për pasojë, vendimi i Gjykatës së Apelit objekt analize, është tashmë edhe përfundimtar, dhe çështja për të cilën ngrihet ky shkak ankimi, është zgjidhur edhe parë në atë këndvështrim.

11.5 Edhe ankuesja duket se ka qenë e ndërgjegjshme për këto aspekte të procesit, më së paku në fillim të vitit 2024, në kushtet që ka kërkuar pezullimin e procesit të rivlerësimit, në pritje të një vendimi nga KLGj-ja për procedimin e saj disiplinor. Konkretisht, më 5.2.2024, ajo referohet të jetë shprehur për Komisionin se:

“[...] Në datën 19.1.2024, jam vënë në dijeni të akteve të nxjerra nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. [...] Në raportin e datës 18.1.2024, për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë [...] thuhet se për caktimin e masës disiplinore, shkarkim nga detyra, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte [...] Sipas këtij raporti, jemi në kushtet e një dënimi me vendim të formës së prerë, pasi vendimi

i fajësisë i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj, vazhdimin e pezullimit të procedurës së vlerësimit e, në rast shkarkimi nga KLGj-ja, do të bëni ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj meje. Sipas nenit 140, pika 2/b e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kompetente në këtë rast, është KLGj-ja [...]”⁴².

11.6 Sa më sipër, merr rëndësi për analizën në drejtim të konstatimit të shprehur më sipër nga Kolegji, për mënyrën sesi ankuesja ka zgjedhur të ndjekë e strukturojë qëndrimet e saj në dy proceset e kryera, duke përdorur në rivlerësim faktin që kishte një procedurë disiplinore për të, ndërsa në procesin e kontestimit të vendimit në procedurën disiplinore, referon procesin e rivlerësimit si bazë për të mbështetur kërkimin e saj për pagën në nivelin 75%, meqenëse ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit.

11.7 Po ashtu, në kushtet që qoftë në planin procedural, ashtu edhe në atë kohor, procesi ka ndjekur një rrjedhë që ka marrë në konsideratë dhe akomoduar gjithë kërkesat e ankueses, ky pretendim rezulton i pambështetur në prova. Neni 118, pika 2, përcakton një afat njëmuor nga marrja e dosjes nga ILD-ja, për KLGj-në, për të caktuar seancën dëgjimore, dhe 15 ditë, më së paku, kundrejt njoftimit, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër, KLGj-ja i ka vendosur seancën dëgjimore më 15.2.2024, brenda afatit ligjor njëmuor për seancën dëgjimore, në kushtet që ILD-ja ka nisur dosjen më 18.1.2024. Po ashtu, dhe pavarësisht se seanca e parë u caktua në një kohë më pak se 15 ditë nga marrja njoftim e konfirmuar nga ankuesja, sipas së njëjtës dispozite ligjore, neni 118, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhënë ankueses kohë shtesë dhe shtyrë seancën tri (3) herë, duke i mundur asaj kohë shtesë për përgatitje, e zgjatur procesin për të akomoduar nevojat e saj në funksion të ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes.

11.8 Së dyti, ILD-ja rezulton të ketë kryer veprimet brenda një harku kohor disajavor, nga 23.12.2023 deri në 18.1.2024. Sikurse parashtroi ILD-ja, diskrecioni kohor prej gjashtë (6) muajsh,

⁴⁰ Urdhrat e Prokurorit, me datë përkatësisht 13.12.2023 dhe 15.12.2023 “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. {***}, datë 15.12.2022, të GjKKO-së, për të dënuarën Mimoza Margjeka [...]”.

⁴¹ Mospranimin e rekurseve të paraqitura nga kërkuessit A. C., Mimoza Margjeka, K. Zh. dhe S. D., kundër vendimit nr. {***}, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

⁴² Vendimi i Komisionit, faqe 9.



njohur nga ligji për kryerjen e hetimit disiplinor, nuk nënkupton që të gjitha hetimet duhet të zgjasin në kufijtë kohorë maksimalë të parashikuar nga ligji. Po ashtu, në kushtet që ligji parashikon vetëm veprime konstatimi nga ILD-ja dhe KLGj-ja në rast se ka një vendim penal të ekzekutueshëm e të formës së prerë, pretendimi i ankueses për trajtim të diferencuar në kushte të njëjta apo të ngjashme me subjekte të tjera (magjistratë), nuk qëndron. Në kushtet kur shkelja e kryer përbën shkak për nisje të procedimit disiplinor, në zbatim të gjithë kuadrin ligjor, këshilli ka detyrimin të vijoje me procedimin e të japë masën përkatëse disiplinore. Në konkluzion të sa më lart, pretendimi i ankueses se iu cenua e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 4, 18 dhe 42 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të KEDNj-së, nuk qëndron.

11.9 Në ndryshim nga sa pretendon ankuesja, procesi disiplinor nuk ka qenë abuziv. Në referim edhe të dy vendimeve të GjEDNj-së që parashtron ankuesja, *Avotins kundër Letonisë*⁴³, si dhe *Dilipak dhe Karakaya kundër Turqisë*⁴⁴, konfirmohet detyrimi i organeve për të kryer të gjitha përpjekjet për të njoftuar palën. Konkretisht, njoftimet janë nisur në disa adresa të ankueses dhe në adresë të avokates, sikurse shtjelluar në detaj më sipër. Procesi disiplinor i kryer ka respektuar të gjitha garancitë e ankueses për proces të rregullt.

11.10 Për sa më sipër, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të ankueses, vendimi nr. 180, datë 9.4.2024, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës

së Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkesa e ankueses Mimoza Margjeka nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistrates Mimoza Margjeka kundër vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 180, datë 9.4.2024, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarës Mimoza Margjeka”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.1.2026.

Shpallur më 9.2.2026.

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtarë: Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz, Albana Shtylla

⁴³ Shih paragrafin 122, në linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-163114%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-163114%22]}).

“122. Në fakt, është e qartë nga informacioni i dhënë nga Qeveria Qipriote, me kërkesë të Dhomës së Madhe, dhe i padiskutuar nga palët, se ligji qipriot i dha aplikantit pasi ai kishte mësuar për ekzistencën e vendimit, një mundësi krejtësisht realiste për të apeluar, pavarësisht kohës që kishte kaluar që nga dhënia e vendimit. [...] Gjykata ka mbajtur vazhdimisht qëndrimin se nëse ka ndonjë dyshim nëse një mjet i caktuar juridik ofron një shans real për sukses, kjo pikë duhet t'u paraqitet gjykatave vendase (shih, për shembull, *Akdivar dhe të tjerë, cituar më sipër*, § 71, dhe *Naydenov kundër Bullgarisë*, nr. 17353/03, § 50, 26 nëntor 2009). Në rastin konkret, gjykata konsideron se, në periudhën midis 16 qershorit 2006 (data në të cilën atij iu dha qasje në të gjithë dosjen e çështjes në ambientet e gjykatës së Faqe| 2566

shkallës së parë dhe ishte në gjendje të njihej me përmbajtjen e vendimit qipriot dhe 31 janarit 2007 (data e seancës dëgjimore të Senatit të Gjykatës së Lartë), aplikanti kishte kohë të mjaftueshme për të ndjekur një mjet juridik në gjykatat qipriote [...]”.

⁴⁴ Shih paragrafin 81 të vendimit të GjEDNj-së në linkun: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-141763%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-141763%22]}).

“81. Gjykata vëren se Gjykata Civile, së pari, u përpoq të dorëzonte thirrjen dhe deklaratën e padisë në adresën e dhënë nga pala paditëse dhe se, meqenëse paditësi nuk mund të gjendej në këtë adresë, ajo më pas vendosi të urdhëronte një kontroll policor. Ajo vëren se Gjykata Civile dërgoi njoftimin e ri në adresën e dhënë nga policia dhe se kjo përpjekje dështoi gjithashtu sepse paditësi nuk ndodhej as në këtë adresë [...]”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 96 lekë